

TC KREMTET E TETORIT

1. *Anania, Apostulli i Shenjte, nje prej te Shtate-dhjeve; Romani Mellodi, Oshenari.*
2. *Kipriani, Hierodeshmori i Shenjte; Justina Vir-gjeresha, Deshmorja e Shenjte.*

3. *Dionisi Areopagiti, Hierodeshmori i Shenjte.*

PERLGSHORJA E SHEN DIONISIT, T. IV.

Mesove butesine, zbatove perkoren, dhe u-veshe me ndergjégjien e mire prifterisht, mesove prej Shpetimtarit te fshehtat, dhe e rúajte besen, e mbarove rendjen e drejte, Hierodeshmór i Shenjte Dionís. Lutju Krishtit Perendí, te shpctohen shpirtet tona.

4. *Jerotheu, Ati yne i Shenjte, peshkopi i Athines.*

PERLGSHORJA E SHEN JEROTHEUT, T. IV.

Mesove butesine, zbatove perkoren, dhe u-veshe me ndergjégjien e mire prifterisht, mesove prej Shpetimtarit te fshehtat, dhe e rúajte besen, e mbarove rendjen e drejte, Hierodeshmór i Shenjte Jerothé. Lutju Krishtit Perendí, te shpctohen shpirtet tona.

5. *Haritina, Deshmorja e Shenjte.*

6. *Shen Thomáj, Apostulli i lavderuar.*

PERLGSHORJA E SHEN THOMAJT, T. IV, EPEFANIS SIMERON

Plot me hirin perendór, ish i permbushur, Apostúll' i Zotit Krisht, dhe sherbetór i tij besnik, dhe i therrite plot me pendím: Ti je per mua, o Zot Perendia im.

7. *Sergi dhe Baku, Deshmoret e Shenjte.*

8. *Pellagia, Nena jone Oshenare.*

9. *Shen Jakobi Alfeu, Apostulli i lavderuar; Androniku, Ati yne Oshenár.*

PERLGSHORJA E SHEN JAKOBIT, T. III.

Jakób Apostúll i Shenjte, lutju Zotit tone Jesú Krisht, tu fale shpírteve tona, ndjesen e mekátave.

10. *Eullambi dhe e motra Eullambia, Deshmoret e Shenjte.*

PERLGSHORJA E EULLAMBIT DHE EULLAMBIÇ, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmoret e tu o Zot, me vojte lot e mundím, kurorc te ndrícime prej teje múarne, si roge dhe si çperblím; se me fuqine tende, i rrezuan tiranct; edhe i shtypne djajte, e kuxímt' e te dobet; atá per né po te luten o Krisht Perendí, te shpctohen shpirtet tona.

11. *Filipi, Apostulli i Shenjte, nje prej te Shtate Dhjákeve; Theofani i Shkruar, Ati yne Oshenár, peshkopi i Nikese.*

PERLGSHORJA E SHEN FILIPIT, T. II.

Filip Apostúll i Shenjte, lutju Zotit tone Jesú Krisht, tu fale shpírteve tona, ndjesen e mekátave.

PERLGSHORJA E THEOFANIT TE SHKUAR, T. T. IV, ORTHODOKSIAS ODHIFE

Udheheqes Orthodóks, dhe mesonjes i besces dhe i perkores je, se na ke ndritur si nje yll, dhe u-tregove si shembell e Kryeprífterve, i urte

Theofán, të gjithë i ndriçove dhe i mesove ti, lira e Shpirtit Shenjt. Lutju Krishtit Perëndí, të shpëtohen shpirtet tona.

E DIELA E SHËN ATËRVE

(Qe me 11-17 të Tetorit)

PERLËSHORJA E ATËRVE TË SHËNJTË, T. T. IV.

I permilavderuar je o Krisht Perëndí dhe Zot, që dergove permi dhé, Aterit tanë të Shenjtë dhe i ndrite, dhe me atá na shpurre në besen e drejtë, dhe na tregove shpëtimin. O meshireplót lavdí me ty.

THIRRTORET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Brenda në shtatë ditë, e bëri Zoti botën, dhe ju në shtatë mbledhje, na regulluat fënë, o Ater të Sinódeve.

Një Perëndí dhe Zot, të ndarë në tre veta, të njëshme nga substanca, dhe një Triní leçitë, o Ater të Sinódeve.

Krishtin si Perëndí, dhe Bir të Perëndisë, dhe Fjalë të panisme, na çfaqte dhe na çpallte, o Ater të Sinódeve.

Shpirtin që frymesój, Profetet dhe Shenjtoret, si Perëndí e çpallte, me Atin e me Birin, o Ater të Sinódeve.

LAVDI DHE TANI. Shtypte çdo heresí, dhe ujqit që përçanin, kopén' e Jesú Krishtit, i çkateruat fare, o Ater të Sinódeve.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Múarte frymesím, prej Shpirtit edhe shkruat, Simbolin e Nikesë, për Kishen Orthodokse, o Ater të Sinódeve.

Kishen e Zotit Krisht, të Shenjt' e të Përgjithme, një dhe Apostolike, e çfaqte dhe e çpallte, o Ater të Sinódeve.

Çfaqte një Pëgzím, mi emrin e Trinisë, dhe Ngjalljen e përgjithme, dhe jetën e përfuntme, o Ater të Sinódeve.

LAVDI DHE TANI. Virgjëren Shen Marí, që lindi Jesú Krishtin, Hyjlíndese si Nënë, të Perëndís' e çfaqte, o Ater të Sinódeve.

Në shërbesën e Mengjëzit këndohen Troparet e zakon-ta të Tingëllit që rastís.

SINAKSARI

Ghjithe sot, kujtojmë Aterit e Shenjtë, të cilet u-mblodhën në Sinodin Ekumeník të Shtatë të Nikesë për Ristoratën e Kóreve.

Me nermjetimet e Aterve të Shenjtë, o Perëndí, meshirona. Amín.

ZBRITËSORET, T. IV, ANIKSO.

I. Ja gojen e çel taní, i frymesuar prej Shpirtit Shenjt, dhe kengë do t' i këndónj, Nenes së Madhe mi fron, dhe do ta kremtónj, me valle buzeqeshur, me ze do t' i çpall kudó, gjithë çudit' e saj.

III. O Zonjë dhe Nen' e Perëndisë, burím i pa-

sosur jetesór, ti shiguroji gjith' atá, qe te ken-
dojne plot me zell, dhe lart ne qell ku mbreterón,
kurorczoji me çdo lavdí.

IV. Te pagjyrmesúarin pllan perëndór, qe po
misherohet i larti Zot prej Virgjereshes, Abaku-
mi si Profét, e pá dhe tha me ze te math: Zot i
fuqishim lavdí me ty.

V. Te gjith' i habite ti, me nje çudí dhe nje
lavdí: Ti o Virgjérësh' e pamartuar, Zotin e jetes
qe mbreterón lart ne qell, si nje bir e mbajte ne
peqí dhe shpetím qe lártazi, u dhurove besníkeve.

VI. Keté te kremte e lusim sot, per Zonjen e-
dhe Nenen Hyjlíndese, gjithë hyjméndesit, eni
trokisni pra dúarte, dhe lavderoni Zotin qe lindi
prej asáj.

VII. Nuk u fálcshin, krijésave hyjméndesit,
po Krijetarit lart, dhe kercenimin me zjarr, e
shkelne me trimerí, psallnin me brohorí: Zot
lavdí me ty, o Perendí i Aterve, ti je vetem
i bekuar.

VIII. Djemat e denuar per te djegur, prej
zjarrit i ka shpetuar lindj' e Zotit Krisht, si sim-
ból ne vjeterí, dhe si veperím taní, dhe tere boten
po e mbleth per keng' e lavderím: Hymnójeni ju
veprat e Zotit, dhe e lartsoni permi te gji-
tha jetet.

IX. Gjithë njérczit, kecení me ngazellím tek
drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójeni, Çngjejt'
e qellit eni kremtójeni, keté te shenjte panaír te
Kryezonjes Marí, dhe therrisni: Ti je mé e lú-

mura, Virgjérësh' e kulluar Hyjlíndese.

DËRGIMCSORET, T. III, EPESKEPSATO

O Shen Ater te Kísheve, u çpallte dogmat pó-
pujve, dhe heretiket beselíq, i çkateruat plote-
rísht; u falte pra besníkeve, ne qellin Mbretë-
rine, Parajsen e Çngjejve.

Nermjetoni tok per né, Shen Ater te Sinódeve,
dhe ti o Zonje Shen Marí, perkrahna prane Birit
tent; nga çdo dením shpetónani, na falni Mbretë-
terine, qellore te Zotit Krisht.

LAVDËRIMET, T. T. II, OLIN APOTHEMENI

Ater te Sinódeve, me diturine mendore, dhe
me Shpirtin Tereshénjt, passi u-ndriçuat misti-
kerísht me hir, nje Simból per besím, Ater bes-
mire, pervijoste hyjerísht per né, dhe e çfaqte
Zotin Krisht, te bashkepanisme si Perendí, dhe
te bashkeqéncshme, ne Trinín' e Atit dhe Shpir-
tit Shenjt, sipas Apostujve, vazhduat predikimet
beserísht, dhe i leçitte me lavderím, dogmat e
besníkeve.

Ater te Sinódeve, me driten tuaj mendore, dhe
me hir te Shpirtit Shenjt, nxúarte orákullin e
doktrínave, nje simból fjale-pák, me kuptím te
thelle, proklamuat prej tribúnave, dhe prej gji-
the Kísheve, ju o Ungjillorc te Zotit Krisht, per-
mbajtes te tradítave, edhe kujdestarc te dógma-
ve; Zoti jua çfaqí, nga qelli dhe ne boten ju der-
gój, tua leçitni besníkeve, besen e Shenjtóreve.

Ater të Sinódeve, o kujdestarë besnikë, dhe barinj të grígjave, plot me zemërim kundër të paúdheve, cilindó ujk të lik, me shigjët' e dbuat, me hobén' e Shpirtit Tereshénjt, i handakoste krejt, gjith' armíqt' e Kishes së hýjeshme; dhe ranc si të vdëkurit, dhe perdhé u-shtrinë për gjithënjé; o Ater të Shenjte, të fjeshtë shërbetorë të Jesújt, o Ungjillorë të dógmave, drita e besnikëve.

LAVDI, T. T. IV. Shoqëria e Aterve me nam, e thirrur dhe e mbledhur prej Kishes në Sinód, caktójt dhe çkoqiti dogmën e Trinisë, me tri persona dhe natyrë të perbashkme, dhe një mistër të math të Theologjisë, një At e Bir dhe Shpirt të perëndishmë. Pra u këdojmë me besë, lumërimë lëndónjëse: Të Shenjte Kryepërfitërinj, dhe ushtarë të Zotit, edhe Engjëj të shkelqyer; o yjtë doktrinave, mi horizontin e drítave; kështjella në Sión, që nukë túndeni kurrë; o aroma prej lúleve të Parajës; o gojë të arta të Ungjillit; o nder i Sinódeve, të Nikés' e të Shtátave, nermjetoni gjithënjé, për shpirtet e lútesve.

TANI. E permibekuar je, o Hyjlíndese Virgjëreshë. Të hymnojmë se prej Birit që lindë, Ferri u-roberua, Adami u-nduall prapë, mallkimi vdiq, Eva u-çlirua, vdekja u-dermua, dhe né múarmë jetë. Perandáj po hymnojmë, dhe thërrësim: I bekuar je, o Krisht Perëndí, që e pelqëve kështú, lavdí më ty.

SHKURTORJA, T. IV, PROSTASIA

O mburónj' e patronditur e të Krishtëreve, nermjetarë e palodhur e besnikëve, vër-u veshin mekatáreve me dhëmpshëri, se po të thërrësim besërishtë, o Nen' e Zotit Jesú Krisht, o Marí Virgjëreshë: Ndhina me nermjetimet, dhe lutjet mëshirëplote, dhe mëpro përherë gjith' atá, që të lusin o Hyjlíndese.

APOSTULLI

I bekuar je, o Zot, o Perëndí i Aterve tanë. Se je i drejtë në të gjitha sa na ke bërë.

Prej Letres së Palit për Titon.

Bir Tito, fjala është e vërtetë, dhe dua të shigúróheni për këtë, se kështú atá, që e besojnë Perëndinë, do të kujdesen të përparojnë me vepra të mira, se këtë janë të mira dhe të dobishme për njërczit. Qendró lark nga bisëdimet e kotta, nga gjeneallogjite, nga grindjet, edhe nga shërret ligjetarë. Hiq dorë prej njeriut heretik, pasi ta keshillósh për herën e parë dhe për herën e dytë, dyke ditur se aý është i përmbysur dhe i dënuar prej veti. Kur të të dërgónj Artemanë, eja mënjeherë të píquemi në Nikopolë, se atjë kam vendosur ta shkonj dimrin. Dërgoji përpara me nxi-tím Zenanë ligjetarin dhe Apollonë, dhe kujdesu që të mos mungonjë asgjé. Le të mesojnë edhe tanët të përparojnë me vepra të mira për nevojat e domosdoshme, që të mos jenë të papemët. Të gjithë atá, që janë bashkë me mua të përshen-

doshin. Pershendósh-i me besë gjithë atá, që na duan. Hiri qofte me ju të gjithë. Amín.

UNGJILLI PAS MATTHEUT

Zoti u tha Dishépujve: Ju jini drita e botes. Një qytét, i vendosur mi një mal, nukë munt të fshihet. Edhe kur e ndezin kandilin, nuk e venë nënë shinikun, po permi kandilerin, që tu ndrite të gjithë atyre, që ndodhen në shtëpí. Keshtú le të shkelqenjë drita juaj përpara njëresve që t' i shikojnë veprat túaja të mira, dhe ta lavderojnë Atin tuaj, që është në qell. Mos pandehni se kam ardhur ta prish ligjen edhe profetët. Nukë kam ardhur ta prish po ta plotesónj. Se me të vertete po ju them, gjer sa të prishet qelli edhe dheu, dhe gjer sa të mbarohen të gjitha, asnjé jotë dhe asnjë vijë e ligjes nukë do të prishet. Aý, pra, që shkel me të vógelen prej këtyre porrosive, a i mesón njërezinë t' i shkelin, do të quhet mé i vógeli në Mbretërinë e qellit; po cilidó, që e zbatón, dhe e predikón, aý do të quhet i math në Mbretërinë e qellit.

KUNGATORJA

I drejti do të kujtohet për jetë.

12. *Probi, Taraku dhe Androniku, Deshmoret e Shenjte.*

13. *Karpi, Papili, Agathodori dhe Agathonika, Deshmoret e Shenjte.*

14. *Nazari, Gjervasi, Protasi dhe Kelsi, Deshmoret e*

Shenjte; Kozmáj Agiopoliti dhe Vjershetori, Ati ynë Oshenár, peshkopi i Majumes.

PERLGSHORJA E KOZMAJT TË MAJUMES, T. T. IV, ORTHODOKSIAS ODHIJE

Udhëheqës Orthodóks, dhe mesonjës i besës dhe i perkores je, se na ke ndritur si një yll, dhe u-tregove si shembell e Kryepríftërve, i urte Shen Kozmáj, të gjithë i ndriçove dhe i mesove ti, lira e Shpirtit Shenjt. Lutju Krishtit Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

15. *Lukani i Antiokisë, Deshmori i Shenjte.*

16. *Longini Kryeqíndesi, Deshmori i Shenjte.*

PERLGSHORJA E SHËN LONGINIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmori yt o Zot, me vojtje lot e mundím, kurorë të ndriçime prej teje mori sot, si roge dhe si çpërblím; se me fuqinë tënde, ka rrezuar tiranet, dhe ka dermuar djajtë, e kuxímt' e të dobet; aý për né po të lutet o Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

17. *Hosia, Profeti i Shenjte; Shen Andrea, Deshmori Oshenár i Krisës.*

PERLGSHORJA E ANDREUT TË KRISËS, T. IV, O IPSOTHIS

Si i stervitur Ashketí neper malet, dermove gjithë ushtërit' e armikut, me armët e pamúndura të Kryqit shpëtimtár, dhe u-nisë për deshmím, u-përveshe si burrë, vrave Mbretin Kopro-

ním, me sepaten e besës, dhe për këtë kurorë merr në qell, Dëshmor' i Shenjtë, André i kujtuarshim.

18. *Shen Lukáj Ungjillori.*

PERLESHORJA E SHEN LUKAJT, T. III

Shen Luká Apostull dhe Ungjillór, lutju Zotit tona Jesú Krisht, tu falë shpërteve tona, ndjesën e mekátave.

THIRRTORET, T. T. IV, TI IMAS.

Si të të levdojmë o Apostull? Si një qell që na tregove, çdo lavdi të Zotit Krisht; shkrepëtím që e shkelqeve, tërë botën me ndriçím; si re e cila derdhi shi prej qiellit; si ene plot me verë të çudíçime, që u jep dëfrím dhe urtesí, zémrave dhe gjithë shpërteve. Të lútemi, nermjetó për në dhe na shpetó.

Si të të levdojmë o Apostull? Si një lume të Parajsës, që na rjeth e na vadít; si një arcë me një dhjatë, që na falë Zoti Krisht; si diell shpirtëror që na ndriçon me gas; si dritë që shkelqén në mes të Kísheve; Buk' e Shenjtë e Alltáreve, Kup' e Kungatës së Shpirtit Shenjt. Të lútemi, nermjetó për në dhe na shpetó.

Si të të levdojmë o Apostull? Meshetár për sakramentat, perëndore të Jesújt; themeltár i Krishterimit, që në Kishën predikón; që pllakat ke latuar të kumándave, që ligjen ke përhapur, dhe një hir të ri, që nga Sión' e Proféteve, e pro-

klamove o Ungjillór. Të lútemi, nermjetó për në dhe na shpetó.

Si të të levdojmë o Apostull? Si thesár të pasurive, të panúmerta në qell; a si mjek a si shëronjes, për çdo zemër dhe çdo shpirt; si shokun e Shen Palit edhe shkronjesin, e Akteve të gjithë Apostujve tok; tituj ke të shum' o Shen Luká, dhe je një pus i virtútave. Të lútemi, nermjetó për në dhe na shpetó.

Si të të levdojmë o Apostull? Si Dishepull që leçite, Shpetimtarin Jesú Krisht; si një mjek që pasionet, i shëron për çdo besnik; si diell shpirtëror që na ndriçon me gas; kollonë dhe themél i gjithë Kísheve; ti që na e shkrove o Luká, Ungjillin e Zotit Jesú Krisht. Të lútemi, nermjetó për në dhe na shpetó.

Si të të levdojmë o Apostull? Meshetár i urtesisë, i vertetë dhe besnik, ti na shkrove na leçite, çdo mesím dhe porrosí, kollón' e gjithë Kísheve të Zotit Krisht, keshtjéll' e patronditur e besnikeve. Të shuma dhe të panúmerta, dhuratat e doktrínave. Të lútemi, nermjetó për në dhe na shpetó.

LAVDI DHE TANI, T. II. O Ungjillór Luká, o Apostull i Shenjtë, pasonjes i Shen Palit, që vepërati u përshkrove, Dishépujve të Zotit Krisht.

PASVARGJET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Hirin e more o Shen Luká, nga gjuh' e zjarrte, përmi koke prej Shpirtit Shenjt, dhe gjuhë të

zjarrte pate, dhe drite hape kudó, kur leçite Fjallin per te vyerit; me shkrim edhe me mesím, e perhabe Ungjillin tent, me shkrepetime i ndriçove te érretit, edhe jet' u dhé, pa mbarím jetedáshesve; bere sikunder te mesój, Shen Pali mesónjcsi, u prure vdekjen dhe humbjen, posi çperblím vdekjeprúresve. Falna paqen neve, dhe meshiren edhe driten, dhe jeten lart ne qell.

Múarme vesh nga shkrimet me ment, sikunder fole, se te drejten na thé o Shenjt, Luká Ungjillór i urte, edhe per né hollesisht, ndenje edhe shkrove sipas lájmave, qe kishe prej shókeve, dhe degjove prej pámesve, me syt' e vete, me te cilet je barabár, si nje lajmetár i Ungjillit te Zotit Krisht; pra udhetove tok me té, pas Ngjalljes ne Emmaús, edhe me zemer te djegur, hengre buke tok me até. Me zellin qe pate, edhe né qe te nderojme, na mbush dhe na ndriçó.

Lum' o Luká qe shkrove per né, Ungjillezimin, e Marise Hyjlíndese, dhe Nenes se Perendise, prej Gabrielit qe tha, Shen Marí gezohu e bekuar je; na çpalle n' Ungjillin tent, jeteshkrimin e Zotit Krisht, fjalet dhe veprat, dhe si vdiq permi Kryq per né, edhe si u-ngjall, dhe pastáj si u-ngjijt ne qell; si zbriti Shpirti Tereshénjt, dhe ç' bene leçitesit, edhe Shen Pali i lumur, qe e ke patur ustá dhe shok. Dishépull i Krishtit, yll i Kishes te cilen, perherc rúaje.

LAVDI DHE TANI, T. II. Mjek edhe Ungjillór, Luká i lavderuar, me nermjetím dhe lútje,

perpara Jesú Krishtit, shpetona prej rezíkeve.

NDENJCSORET, T. T. IV, TIN SOFIAN

Si nje shok me Shen Palin po veperón, dhe reziket e ndryshme po i durón, Luká i shkelqýeri, Apostulli i Zotit Krisht; e mbarove rendjen, e bescs me trimerí, dhe taní ne Parajsen gezohesh dhe po defrén; ndrite tere boten, se leçite Ungjillin, dhe fjalet e hýjeshme, dhe shpetimin per njérezit, perandáj te therresim: Iu-lut Perendise gjithenjé, te na dhuronje ndjesen e mekátave, neve qe po kremtojme, beserisht kujtimin tent.

LAVDI DHE TANI. Shpirtin tim te perunjur o Shen Marí, qe me shqoten e jetes brenda ne det, po rrihet prej ércve, dhe perpiqet prej válave, edhe nga barr' e mekatit po mbytet prej újeve, edhe ne funt te Ferrit po kridhet taní me vrap; eja Virgjereshe, dhe me lutjet e nxehta, shpctome dhe shpjerme shpejt, ne limán dhe ne qetesí; se me bese po te therrés: Lutu-i Birit Jesú Krisht te na dhuronje ndjesen e fájeve, se me ty kemi shprese, gjithc te pavýerit.

Megéneqe nuke ka Ungjill te Mengjezit, pas Ndenjesoreve thuhet menjehere:

SHKURTORJA, T. IV, EPEFANIS.

Shen Luká o Apostull, i lavderuar, ndrite me Shen Palin tok, te gjithc njérezit mi dhé, dhe erresiren e çduke krejt, kur na pershkrove, Ungjillin e Zotit Krisht.

SHTËPIA

Si mjek edhe dishepull i dashur, o Shen Luká, shërona-i sëmundjet e shpirtit edhe të trupit, që ta kremtojmë me besë kujtimin tënt, se ti na ndriçove dhe ti na shpetove, kur na përshkrove Ungjillin e Zotit Krisht.

SINAKSARI

Me tërëmbëdhjetë të keti mija, kujtojmë Shen Lukanc, Ungjillorin dhe Apostullin e lavderuar.

Gjithë sot, kujtojmë Marinin, Dëshmorin e Shenjtë.

Gjithë sot, kujtojmë Julianin e Eufratit, Atin të Oshenár.

Me nërmjetimet e tyre, o Perëndi, mëshirona. Amin.

ZBRITËSORET, T. IV, ANIKSO.

I. Ja gojen e çel tëni, i frymësuar prej Shpirtit Shenjt, dhe këngë do t' i këndonj, Nenes se Madhe mi fron, dhe do ta kremtonj, me valle buzeqeshur, me zë do t' i çpall këdo, gjithë çudit' e saj.

III. O Zonjë dhe Nen' e Perëndisë, burim i pasosur jetësor, ti shiguroji gjith' atá, që të këndonjë plot me zell, dhe lart në qell ku mbretëron, kurorëzoji me çdo lavdi.

IV. Të pagjyrmësuarin pllan perëndor, që po mishërohet i larti Zot prej Virgjërshes, Abaku-

mi si Profët, e pá dhe tha me zë të math: Zot i fuqishim lavdi me ty.

V. Të gjith' i habite ti, me një çudi dhe një lavdi: Ti o Virgjërsh' e pamartuar, Zotin e jetës që mbretëron lart në qell, si një bir e mbajte në peqi dhe shpetim që lartazi, u dhurove besnikëve.

VI. Këtë të kremte e lusim sot, për Zonjen edhe Nenen Hyjlindëse, gjithë hyjmëndësit, eni trokisni për dëarte, dhe lavderoni Zotin që lindi prej asáj.

VII. Nuk u fálcshin, krijësavë hyjmëndësit, po Krijëtarit lart, dhe kërcenimin me zjarr, e shkelne me trimëri, psallnin me brohorí: Zot lavdi me ty, o Perëndi i Aterve, ti je vetëm i bekuar.

VIII. Djemat e denuar për të djegur, prej zjarrit i ka shpetuar lindj' e Zotit Krisht, si simbol në vjetëri, dhe si veperim tëni, dhe tërë botën po e mbleth për këng' e lavderim: Hymnójeni ju veprat e Zotit, dhe e lartësoni përmi të gjitha jetët.

IX. Gjithë njërezit, këceni me ngazellim tek drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójeni, Çngjëjt' e qellit eni kremtójeni, këtë të shenjtë panair të Kryezonjës Marí, dhe thërrisni: Ti je më e lumura, Virgjërsh' e kulluar Hyjlindëse.

DËRGIMËSORET, T. II, TIS MATHITES

O Apostull i Zotit Krisht, Luká i lavderuar, o Ungjillor i kómbeve, me Shen Palin e lumur,

dhe Shen Marín' e bekuar, që i ke pikturuar, konizmen çudibërëse, nermjetó pa pushuar dhe nxehterísht, të shpetohen gjith' atá që kremtojnë, me besë jetendrimin tent, o leçites i urte.

O Shen Marí Hyjlíndese, mprona prej çdo reziku, mprona prej hidherímeve, mprona prej çdo nevoje, dhe mos na ler të na marre, djalli ditën e funtme, as Ferr' i erresírave; mprona përpara gjyqit të Birit tent, nxirna faqebardhe o Virgjereshe; si Nen' e Zotit ti i ke, që të gjitha në dorë.

LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Në tërë dhen' u-degjua nami yt o Luká, Shen Apostúll i lumur, që përhapë Ungjillin, dhe dogmen Orthodokse që na leçit, Atin Birin dhe Shpirtin Shenjt, që adhurojmë të gjithë mistikerísht, si Triní të bashkeqénshime.

Si Ungjillór të shkelqyer të Zotit Jesú Krisht, edhe si yll të ndriçim, t' orizontit të Kishes, të quajmë të gjithë o Shen Luká, dhe nga shpirti ndriçóhemi, se nermjetón dhe na fal gjithënjë shpetím, edhe ndjesh të mekátave.

E more Kryqin mi supet si na tha Zoti Krisht, dhe dollë faqebardhe, dhe fitove kuroren, me djerse dhe mundime o Shen Luká, dhe keshtú trashëgón në qell, Parajsen tok me Shenjtoret dhe nermjetón, për shpetimin e besnikëve.

LAVDI, T. T. IV. Ejani besnikë, le t' i therrsim me kengë Davidike, shkrimtarit mistík Shen Luká: Penda jote e mprehte, i zbukurój vizionet

e Krishtit, edhe u leçite Ungjillin kómbeve, edhe u përshkrove veprat Apostujve dhe shókeve. Përandáj përpara Perendisë Trinisore, nermjetó për shpetimin e shpërtheve tona.

TANI. Prit-i Hyjlíndese, lutjet e shërbetóreve, përkrahna dhe shpetona, prej rezíkeve dhe hëlmeve.

SHKURTORJA, T. IV, PROSTASIA.

O mburónj' e patronditur e të Krishtëreve, nermjetare e palodhur e besnikëve, vër-u veshin mekátareve me dhempsherí, se po të therrsim beserísht, o Nen' e Zotit Jesú Krisht, o Marí Virgjereshe: Ndiha me nermjetimet, dhe lutjet meshireplote, dhe më përherë gjith' atá, që të lusim o Hyjlíndese.

APOSTULLI

Fama e tij u-përhap në tërë botën. Qelli tregón lavdime e Perendisë.

Për Letrës së Palit për Kollosianët.

Vellezer, silluni urte me të jashtmet për të fituar kohë. Flisni gjithënjë me hir dhe me kripë, dhe mesoni tu jepni përgjigjen të gjithëve. Punet e mia do tua tregojnë të gjitha Tihikój, vëlláj i dashur, shërbetori besnik dhe shoku me Zotin, të cilin ua dergova pikerísht për këtë qellim, që të mesonjë gjendjen tuaj, dhe tju ngushellojnë zemrat, tok me Onesimin, vëllanë e dashur dhe besnik, i cili është nga túajtë. Këtë do tjuaj

tregojne lajmet e ketushme. Ju dergojne te fala Aristarku, te cilin e kam shok ne burk, edhe Marku i nipi i Barnabes, per te cilin ju kam dhene porrosira; kur tju vinje, priteni. Gjithashtu ju dergon te fala edhe Jesuj, i quajtur Justi. Ketaj Judenj jane te vetemit bashkepuncture per Mbretesine e qellit, qe me kane ngushelluar. Ju dergojne te fala Lukaj, mjeku i dashur, dhe Demaj. Pershendoshini vellzerit ne Laodike, edhe Nifane, edhe Kishen ne shtepine e tij. Edhe pasi ta kendeni ketë leter, dergojeni ne Laodike, qe ta kendonje edhe Kisha e atjeshme. Gjithashtu edhe ju kendeni letren prej Laodikes. Edhe i thoni Arkipit qe te kujdeset per te mbaruar misionin, qe ka marre prej Zotit. Ju dergojn te fala me doren time edhe une Pali. Kujtomeni ne burk. Hiri qofte me ju. Amin.

UNGJILLI PAS LUKAJT

Zoti u-tha Dishepujve: "Aý, qe ju degjon ju, me degjon mua; dhe aý, qe ju perbuz ju, me perbuz mua; dhe aý, qe me perbuz mua, perbuz atë, qe me ka derguar." Edhe te Shtatedhjetet ukthyen prape me gas, edhe i thane: "O Zot, edhe demonet na binden me emrin tent." Edhe Jesuj u tha: "E pashe Satanin qe u-vezua nga qelli si rufé. Ja ku ju jap fuqi te shkeleni mi gjeperinj edhe agrepe dhe mi tere poteren e armikut, edhe asgjé nuke do tju benje dem. Po mos u-gezoni per keté, qe frymat ju binden, po u-gezoni me te-

per qe emrat tujaja jane shkruar ne qell." Edhe m' atë ore, Jesujt iu-gezua shpirti, dhe tha: "Te perhironj, o Ate, o Zot i qellit edhe i dheut, qe ketó ua ke fshehur te urteve dhe te mençurve, dhe ua ke zbuluar foshnjave. Po, o Ate, se ashtu te pelqeu me mire."

KUNGATORJA

Fama e tij u-perhap ne tere boten.

19. *Joeli, Profeti i Shenjte; Vari, Deshmori i Shenjte.*

20. *Shen Artemi, Deshmori i Math; Gjerasimi, Ati yne Oshenár dhe hyjprures, Ashketiu i ri i Kefallonise.*

PERLESHORJA E SHEN ARTEMIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmori yt o Zot, me vajtje lot e mudim, kurorë te ndrime prej teje mori sot, si roge dhe si qperblim; se me fuqine tende, ka rrezuar tiranet, dhe ka dermuar djajte, e kuximt' e te dobet; aý per né po te lutet o Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

21. *Illarioni i Math, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E SHEN ILLARIONIT, T. T. IV, TES TON DHAKRION SU

Me lote derdhur si reké, shkretetiren e that' e vadite per lerim, dhe me vajtim dhe psheretim, gjer nje qint here peme mblodhe per çdo mundim; u-çfaqe pra si yll, dhe e ndrime boten me çdo çudí, Illarion i Shenjte dhe Oshenár, lutju Zotit Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

22. *Shen Averqi, shoku i Apostujve, peshkopi i Hieropojës, çudibéresi; te Shtate Djemat e Shenjte te Efeses, Maksimiani, Jambliku, Martiniani, Dionisi, Andoni, Eksakustodiani, dhe Kostandini.*

23. *Shen Jakobi, Apostulli, i velláj i Krishtit, peshkopi i pare i Jerusalemit.*

PERLESHORJA E SHEN JAKOBIT, T. IV.

Si Dishépull i Zotit, o i Drejte more persiper Ungjillin; ke durimin e patundur si Deshmór; ke kuximin si vellá i Perendise; ke nermjetimin si Kryeprift; pra lutju Krishtit Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

24. *Aretha, Deshmori i Shenjte, me shoket.*

25. *Markiani dhe Martiri, Deshmoret dhe Notaret e Shenjte.*

PERLESHORJA E SHEN MARTIRIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmoret e tu o Zot, me vojtje lot e mundím, kurore te ndrícime prej teje múarne, si roge dhe si çperblím; se me fuqine tende i rrezuan tiranet; edhe i shtypne dajte, e kuxím' e te dobet; atá per né po te luten o Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

26. *Shen Mitri.*

PERLESHORJA E SHEN MITRIT, T. III, MEGAN EVRATO

Perluftár te math neper reziket, te ka gjetur ty bota e tere, se i theve paganet o Athlofór. Pra siç e shtrive Lyeun fodúll perdhé, kur e forcove

Deshmorin Nestór ne stad, gjithashtú o Shenjt, iu-lut Jesú Krishtit Perendí, te na dhuronje per-dellimin e math.

PERLESHORJA E TERMETIT, T. T. IV.

Ti qe shtie syrin mi dhé, dhe e ben qe te dri-dhet, ti na shpetó nga cilidó kerecním dhe ter-mét, o Krisht Perendí dhe Zot, dhe dergona gji-thenjé, pa kursím per-dellimin tent, me lutjet e Virgjreshes, dhe ti na shpetó.

THIRRTORET, T. T. IV, O TU PARADHOKSU.

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Si lart ne qell dhe mi dhé, mbreterón ngazellimi sot, per te kremten me shkelqím, te Shen Mitrit qe lusim sot. Kurorezohet lart midís Engjejeve, dhe lav-derohet poshte prej njéresve. Sa rende na desh-mój, dhe sa bukur na leftój dhe e dermój, djallin e Sketerrave, dhe Krishti triumfój.

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Ndrite shkel-qeve mi dhé, ca mé teper se díelli, o Deshmór Shen Mitr' i Math, anembane rigátave, i lavderuar prej Dritedhénesit, dhe i gezuar prej Jetebéresit; ret' e barbáreve, i perndave dhe i çthure plots-riisht, tufat e lengátave, djajt' e Sketerrave.

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Vdiqe per Zotin Krisht, me nje shpate si nje Deshmór, edhe per armiqtë je, shpat' e mpreht' e dygójeshme, dhe kor ordirat e mburravéceve, dhe grin taboret e te mallkúarve. Eni therrisni pra: O Shen Miter

o Deshmór i Math me nam, mprona edhe rúaajna, né qe te lusim sot.

LAVDI, T. II. Mblídhuni me gczím, kremtóje-ni Shen Mitrin, Deshmorin e degjuar, se nermjetón pa prerc, per shpirtet e besníkeve.

TANI. O Zonje Shen Marí, o Nen' e Jesú Krish-tit, perkrahna dhe shpctona, me lutje shigurona, Parajsen e Shenjtóreve.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Zoti me zemcrím, sheh dhenc dhe ky dridhet, nga frika tunden malet, po ti o Zot i dhempshur, shpctona nga termét' i keq.

Zot mos na çkaterró, per fajet dhe mekatat, qe beme nga padija, dhe per banesat tona, meshire kij te lútemi.

Ja ku pendóhemi, si Ninevíj' e vjeter, Jonanc kur u çove, dhe me termét i trembe, pra falna si atá dhe né.

LAVDI DHE TANI. Pópullin na e mpro, Deshmór i Math Shen Miter, nga drithmat e termetit, nga zia dhe murtaja, dhe shkeljet e barbáreve.

NDENJESORET, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

E kremtja e ndrícime, Deshmór Shen Miter i Math, me gas e permbushi sot, Kishen e Zotit Jesú, te gjith' i permbloodhi tok, kenge dhe lavderime, te te sjellin me besc, ushtár i Shpetimtarit, qe dermove demonet, per né pra nermjetó pa pushím, dhe na shpetó gjithenjé.

LAVDI. O mburónj' e Deshmóreve, Deshmór Shen Miter i Math, u-veshe me Zotin Krisht, dhe e dermove perdhé, armikun e shtype krejt, çduke gjithc genjeshtaret, e pagáneve fare, mprojte çdo besemire, nga reziku dhe ndjekja; te lusim pra me besc, besniket dhe kremtónjesit.

TANI. O Shpres' e besníkeve, qe kanc besc me ty, o Zonje Hyjlíndese, o Virgjereshe Marí, o Nena e Zotit Krisht, lutju tok me Shenjtoret, dhe me gjith' Apostujte, paqen edhe meshiren, terc botes t' i fale, dhe neve qe te lusim, shpetimin e perjéteshme.

T. T. I, TON SINANARKHON

Me nje fé te patundur Deshmór i Zotit Krisht, tiranít' i permbysi dhe i dermój burrerisht dhe Satanin e paudhe e leftój me zell, dhe per mundimet si çperblím, mori dhuraten vleresisht, si çudiberes i çquar, me hirin e Perendise, dhe pranc Zotit nermjetón per né.

LAVDI DHE TANI. Lum' ti porte qellore e Shpetimtarit Jesú, lum' ti mprojtj' e atyre qe po perikin me ty; o limán i dimerónjesve Hyjlíndese, qe ke lindur mishcrisht, Krishtin njerí dhe Perendí per né nermjetó pa prerc, se ty te lavderojme, dhe adhurojme hirin tent.

T. III, TIN OREOTITA

O fort i dáshuri, Deshmór i Zotit Krisht, ty po te lútemi, te gjithc sot me mall, ti na shpetó nga çdo rezík qe turret mi né te mjeret; eja dhe na

vizitó, na shero prej lengátave, shtyp-i te terbú-
arit, kundershatare o Shenjt i Math; dhe paqen u
dhuro gjithenjë, fálesve dhe lavderónjesve.

LAVDI DHE TANI. Zonje Hyjlíndese, Nena e
Zotit Krisht, shpirtin qe m' u-semúr, eja dhe ma
shero, se jam i mbytur ploterisht prej fájeve Vir-
gjeresh; ty pra te therrés me mall, dhe me ze-
mer renkónjese: Prit-me e panjólshime, meka-
tarin vajtónjesin, qe po te pershendósh posi En-
gjelli: Gezohu o Hirplote.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne,
po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zo-
tit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr
jete çdo shpirt, dhe lartesohe ne paqesi, dhe
ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin
burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per je-
telindje.

PARÇVARGU: Perendia ka bere çudira me
Shenjtoret.

UNGGJILLI I MENGJEZIT PAS LUKAJT

Zoti u-tha Dishépujve: Rúajuni nga njérczit,
se do tju kapin, dhe do tju ndjekin, dhe do tju do-
rezojne neper sinagoja dhe neper burgje, dhe do
tju shpien perpara mbréterve dhe princerve per
emrin tim. Dhe kjo do tju behet per deshímim.

Vendosni pra ne zemrat túaja te mos paremejto-
ni se qysh do te mpróheni, se une do tju jap goje
dhe urtesí, te cilen nuke do te mundin ta perba-
llin kundershataret tuaj. Dhe do te dorezóheni e-
dhe prej prínderve edhe vellézerve dhe gjirinjve
dhe miqve, edhe disa prej jush do te vriten, dhe
do te jini te urryer prej te gjítheve per emrin tim,
po asnjé qime e kokes suaj nuke do te humbase.
Do ta zoteroni shpirtin me durimin tuaj.

Psalmi 51 pa ze.

LAVDI. Me nermjetimet e Athloforit, o me-
shireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshi-
replót, shúaji paudhesít' e mia.

*Meshirome, o Perendi meshireplót, edhe shúaji paudhe-
sít' e mia.*

T. II. Pópullin na e mpro, Deshmór i Math
Shen Miter, nga drithmat e termetit, nga zia dhe
murtaja, dhe shkeljet e barbáreve.

SHKURTORJA, T. II.

E skuqe Kishen me valat e gjákrave, Shen
Miter o Miroblét o Deshmór i Math, po ti s' u-
trondite prej vójtjeve, se te forcój Perendia dhe
Zoti Krisht, o mprojtes i forte i pópullit.

SHTÇPIA

Le ta nderojme Shen Mitrin, si ushtar te Krish-
tit dhe si Deshmór te Math, edhe le t' i therrsim
me kenge dhe me hymne: Shpetona nga trondit-

jet e termetit, se prej teje kemi shprese te shpctojme prej rezikeve dhe hélmeve, o mprojtes i forte i pópullit.

SINAKSARI

Me njezét e gjashte te ketí múaji kujtojmé Shen Mitrin, Miroletin, Deshmorin e Math, te lavderuar dhe çudibéresin.

Gjithé sot, Artemidori dhe Basili, Deshmoret e Shenjte, mbaruan jeten te vrare me shpate.

Gjithé sot, Leptina, Deshmorja e Shenjte, mbarój jeten e zvarnisur perdhé.

Gjithé sot, Glikoni, Deshmori i Shenjte, mbarój jeten i vrare me shpate.

Gjithé sot, kujtojmé Termetin e Math edhe te tmerruar.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirona dhe shpctona. Amín.

ZBRITCSORET, T. IV, ANIKSO.

I. Ja gojen e çel taní, i frymesuar prej Shpirtit Shenjt, dhe kenge do t' i kendónj, Nenes se Madhe mi fron, dhe do ta kremtónj, me valle buzeqeshur, me ze do t' i çpall kudó, gjithe çudít' e saj.

III. O Zonje dhe Nen' e Perendise, burím i pasosur jetesór, ti shiguroji gjith' atá, qe te kendojne plot me zell, dhe lart ne qell ku mbreterón, kurorczoji me çdo lavdí.

IV. Te pagjymesúarin pplan perendór, qe po misherohet i larti Zot prej Virgjereshes, Abaku-

mi si Profét, e pá dhe tha me ze te math: Zot i fuqichim lavdí me ty.

V. Te gjith' i habite ti, me nje çudí dhe nje lavdí: Ti o Virgjérësh' e pamartuar, Zotin e jetes qe mbreterón lart ne qell, si nje bir e mbajte ne peqí dhe shpetím qe lártazi, u dhurove besnikëve.

VI. Keté te kremte e lusim sot, per Zonjen e dhe Nenen Hyjlíndese, gjithe hyjméndesit, eni trokisni pra dúarte, dhe lavderoni Zotin qe lindi prej asáj.

VII. Nuk u fáleshin, krijésave hyjméndesit, po Krijetarit lart, dhe kerccnimin me zjarr, e shkelne me trimerí, psallnin me brohorí: Zot lavdí me ty, o Perendí i Aterve, ti je vetem i bekuar.

VIII. Djemat e denuar per te djegur, prej zjarrit i ka shpetuar lindj' e Zotit Krisht, si simból ne vjeterí, dhe si veperím taní, dhe tere boten po e mbleth per keng' e lavderím: Hymnójeni ju veprat e Zotit, dhe e lartsoni permi te gjitha jetet.

IX. Gjithé njérczit, keceni me ngazellím tek drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójeni, Çngjejt' e qellit eni kremtójeni, keté te shenjte panaír te Kryezonjes Marí, dhe therrisni: Ti je mé e lúmura, Virgjérësh' e kulluar Hyjlíndese.

DERGIMCSORET, T. II, TIS MATHITES

Shen Miter o Deshmór i Math, siç ia unje Lieut, kabardisjet e zbrázura, edhe mburrjet e fry-

ra, me hirin e perëndishme, kur forcove n' arenë, Nestorin me bekimin tent, dhe me forcën e Kryqit pra gjithashtu, edhe mua kurdoherë forcome, kunder demoneve të liq, dhe kunder gjithë ngásjeve.

HYJLINDËSORE. Perpara Zotit Jesú Krisht, që e linde e virgjër, o Shen Marí Hyjlíndese, nermjetó pa pushuar, për mekatarët besnikë, që të gjejmë meshirë, dhe ndihmë të volítime, në shtrengíc' e nevojë dhe në rezík, në termét dhe në tronditjet e renda, eja shpetona gjithënjé, si një Nënë e dhempshur.

LAVDGRIMET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Eja Deshmór i Krishtit në né, që po kerkojmë, nermjetím edhe vizitím, shpetona nga mizoritë dhe tiranitë pa funt, dhe nga herezia çkate-rrónjese; prej kesáj roberóhemi, dhe të çveshur po ndíqemi, ketú dhe gjetke, gjithënjé po çvendósemi, arratísemi, nëpër shpellat e máleve. Ti pra na meshiró o Shenjt, dhe prehjen na fal taní, eja pushoje furtunën, edhe shpetona prej válave; me lutje për Zotin, që i fali njëzisë, meshirën pa kufí.

Mur dhe keshtjelle je gjithënjé, dhe nukë trembesh nga rethím' i barbáreve, dhe hovin u pret armiqve, edhe Satanit të lik, dhe pushón terbi-met e semúndjeve; kollón' e patundur je, dhe themél që tronditje s' ke, mprojtes dhe ndihmes, shiguronjes dhe perlufatár, u-tregove ti, o Deshmór për qytetin tent; eja Shen Miter dhe taní,

shpctoje nga çdo rezík, nga çdo nevoj' e shtrengice, me lutjet e papushúara; për Krishtin dhe Zotin, që i fali njëzisë, meshirën pa kufí.

Ndritte me çdo të mir' e virtút, o Athlofore, o Deshmore të Zotit Krisht, keshtú pra e trashëguat, jeten e qellit pa funt, edhe në Parajse ngazellóheni; në mes të ketyre ti, o Shen Miter Deshmór i Math, je lavderuar, si i par' i Dishépujve, se je bërë shok, me Jesunë nga shtíjca; lutju pra njëzisë për né, që sot po të fálemi, dhe na shpetó nga pesimet, dhe nga reziket që s' kanë funt; me anën e Krishtit, që i fali njëzisë, meshirën pa kufí.

LAVDI, T. IV. Le ta nderojmë Shen Mitrin, se trashëgój me shtíjzen hirin e brinjës së Shpctimtarit, se ndriti me urtesinë dhe mesimet, se e mbarój rendjen me gjak, se e fitój kuroren si Deshmór, se ndriti në tërë botën me çudira, se i ka dashur të váfërit, edhe na fal shërime për lengatat me anën e Krishtit.

TANI. Shpetona prej shtrengícave, o Nen' e Krishtit Perëndí, Krijetarit të gjithësisë, se të gjithë të thërresim: Gezohu o mprójtese e shpírteve tona.

SHKURTORJA, T. IV, PROSTASIA.

O mburónj' e patronditur e të Krishtëreve, nermjetare e palodhur e besnikëve, ver-u veshin mekatáreve me dhempshëri, se po të thërresim besërisht, o Nen' e Zotit Jesú Krisht, o Marí Virgjreshë: Ndhina me nermjetimet, dhe lutjet

meshireplote, dhe mpro perhere gjith' atá, qe te lusin o Hyjlíndese.

APOSTULLI

I drejti do te gezohet me Zotin. Degjoma zerin, o Perendí.

Prej Letres II se Palit per Timothene.

Bir Timothé, forcohu me hirin e Jesú Krishtit, edhe ató, qe ke degjuar prej meje, me shume deshmore, ua dorezó njéresve besnike, te cilet jane te zotet tua mesojne edhe te tjéreve. Edhe duroji te keqiat, si ushtár i mire i Jesú Krishtit. Asnjé njerí, i cili vete ushtár, nuke ngaterrohet ne andrallat e jetes, po perpiqet t' i pelqenje gjeneralit te vete. Dhe askúsh nuk e fitón kuroren e trimerise veç neqóftese trimerón pas ligjes. Bujku, i cili mundohet, ka te drejte te marre nje pjese te pémeve i pari. Kupetoji ató, qe them, edhe Zoti te dhente ment per te gjitha. Kujtoje Jesú Krishtin prej fares se Davidit, i cili u-ngjáll se vdékuresh pas Ungjillit tim, per te cilin vuanj te keqia gjer ne burk si nonjë keqberes, po fjala e Perendise nuke lidhet me vargónj. Perandáj, i durónj te gjitha per te zgjédhurit, qe te gjejne edhe atá shpëtimin e Jesú Krishtit edhe lavdine e pasosur.

UNGGJILLI PAS JOANIT

Zoti u tha Dishépujve: Kjo eshte porrosia ime, doni njerjatin. Neqóftese bota ju urrén, díjeni

se mua me ka urryer mé pare se ju. Sikur te ishit prej botes, bota do tju deshte si te sajte, po me-qéneqe nuke jini prej botes, nga e cila ju kam zgjedhur une, perandáj bota ju urrén. Kujtójeni fjalen, qe ju thashe. Nuke ka sherbetór mé te math se i Zoti. Atá, qe me kane ndjekur mua, do tju ndjekin edhe ju. Atá, qe kane rúajtur fjalen time, do ta rúajne edhe túajen. Edhe ketó te gjitha do tjua bejne per emrin tim, se nuk e njohin até, qe me ka derguar. Sikur te mos kisha ardhur dhe te mos u kisha folur, nuke do te kishin mekát. Po taní nuke kane mehane per mekatin e tyre. Aý, qe me urrén mua, urrén edhe tim Ate. Sikur te mos kisha bere perpara tyre veprat, te cilat nuk i ka bere asnjé tjater, nuke do te kishin mekát, po taní edhe i kane pare veprat edhe me kane urryer edhe mua edhe tim-Ate. Edhe keshtú mbushen fjalet e shkrúara ne ligjen e tyre, qe me urryen darovísht. Edhe kur te vinje Ngu-shellimtari, Shpirti i se vertetes, qe dergohet prej Atit, te cilin do tjua dergónj une me anen e Atit, aý do te deshmonje per mua. Po edhe ju deshmoni, se kini qene me mua qe ne krye. Ketó jua thashe, qe te mos skandalizóheni. Do tju nxíerin jashte sinagójave, edhe vjen ora, ne te cilen atá, qe do tju vrasin, do te mburren se i bene nje sherbím Perendise.

KUNGATORJA

I drejti do te kujtohet per jete.

27. Nestori, *Deshmori i Shenjte*.

28. Terenti dhe e shoqja Neonilla, Deshmoret e Shenjte, dhe te shtate femijet e tyre; Stefani Sabaiti, Ati yne Oshenár.

PERLGSHORJA E STEFANIT SABAITIT,
T. T. IV, ORTHODOKSIAS ODHUJE

Udhëheqës Orthodóks, dhe mesonjes i besës dhe i perkores je, se na ke ndritur si një yll, dhe u-tregove si shembell e Kryepërfiterve, i urte Shen Stefán, të gjithë i ndriçove dhe i mësove ti, lira e Shpirtit Shenjt. Lutju Krishtit Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

29. Anastasia e Romes, Deshmorja e Shenjte dhe Oshenare; Avrami, Ati yne Oshenár.

PERLGSHORJA E SHEN ANASTASISË,
T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Shqerra jote o Jesús, me ze të math po të the-rrét: Dhënter ty të desherónj, dhe nat' e ditë të kerkónj, dhe kryqësohem dhe varrosem tok me Pëgzimin; edhe vuanj tok me ty, që të gezohem tok me ty, edhe vdes për emrin tënt, që tok me ty të rronj në qell; po si një fli të shenjte prit-me mua që për ty sakrifikohem. Degjona lutjet, edhe shpëtoji, shpirtet tona prej vdekjes.

30. Zenobi dhe e motra Zenobia, Deshmoret e Shenjte.

31. Staki, Apelli, Ambli, Urbani, Narkisi dhe Aristobuli, Apostujte e Shenjte prej të Shtatedhjetëve; Epimaku, Deshmori i Shenjte.